



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM**

**LEZHË**



**PËRMBAJTJA E RAPORTIT VJETOR**

**TË**

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT  
TË PËRGJITHSHËM**

**LEZHË**

**PËR VITIN 2023**

## Tabela e përmbajtjes

HYRJE .....	4
I-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2022 ...	5
1.1-TË DHËNA PËRREALIZIMIN E OBJEKTIVAVE PRIORITARE TË PROKURORISË .....	5
1.2-RRITJA E ROLIT AKTIV TË PROKURORIT DHE HETIMET PROAKTIVE .....	5
1.3-INFORMACION MBI ZBATIMIN E UDHËZIMEVE TË PËRGJITHSHME TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM .....	6
1.4-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REZOLUTËS SË KUVENDIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË SAJ.....	6
1.5-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM .....	8
1.6-RESPEKTIMI I TË DREJTAVE DHE INTERESAVE TË LIGJSHME TË SHETETASVE NË PROCESIN PENAL .....	11
1.7-TË MITURIT DHE GRUPET VULNERABËL , TË PANDEHUR DHE VIKTIMA .....	12
1.8-BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL.....	13
1.9-BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	14
1.10-TË DHËNA LIDHUR ME TRAJNIMET E PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE.....	14
II-ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË .....	15
2.1-VOLUMI I PUNËS NË HETIM .....	15
2.2-ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË .....	17
2.3-TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË.....	17
2.4-TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE.....	20
2.5-TË DHËNA NË LIDHJE ME MASAT E SIGURIMIT PERSONAL DHE PASUROR .....	21
2.6-TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË.....	25
2.7-KRIMINALITETI SIPAS SHTRIRJE TERRITORIALE.....	25
2.8-KRIMINALITETI SIPAS PËRHAPJES SË VEPRAVE PENALE DHE TENDENCAVE TË TYRE .....	25

2.9-KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL (KRIME-KUNDRAVAJTJE) ....	26
III-TREGUESIT STATISTIKORË 2 VJECARE TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL .....	26
3.1-NË VITIN 2021 .....	27
3.2-NË VITIN 2022 .....	26
IV-ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË .....	28
4.1-TREGUESI I EFEKTIVITETIT NË GJYKIMIN DHE NË DENIMIN E TË PANDEHURVE .....	28
4.2-TË DHËNA PËR GJYKIMET E POSAÇME.....	29
4.3-TË DHËNA MBI LLOJET DHE MASAT E DËNIMEVE .....	29
4.4-TË DHËNA SOCIALE DHE DEMOGRAFIKE PËR TË PANDEHURIT .....	31
4.5-TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT E MITUR .....	31
4.6-TË DHËNA PËR PASOJAT E VEPRAVE PENALE.....	31
V-TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA .....	32
5.1-EKSTRADIME, LETËRPOROSI, TRANSFERIME PROCEDIMESH, TRANSFERIME TË DËNUARISH, SHPALLJET/HEQJET NGA KËRKIMI NDËRKOMBËTAR .....	32
VI-TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE.....	32
6.1-TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS SË PROKURORËVE.....	32
6.2-TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS SË OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE .....	37
VII-INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË.....	39
VIII-INFORMACION PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAT.....	43
IX-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2022 DHE REKOMANDIME .....	43
NË VEND TË MBYLLJES .....	46
<i>Shtojcë:Tabelat e treguesve statistikor 2 vjeçar të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal.....</i>	<i>47</i>

**HYRJE****DREJTUAR****PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM****Z. Olsian ÇELA****TIRANË****I nderuar Z. Prokuror i Përgjithshëm!**

Në këtë raport synojmë të prezantojmë të dhënat dhe treguesit e ecuresisë së veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për vitin 2023.

Ky raport përmban të dhëna që i referohen veprimtarisë së Prokurorisë në fazën e hetimit paraprak, në fazën e gjyimit, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, të bashkëpunimit ndërkombëtar si edhe zbatimit të detyrimeve të tjera ligjore të normuara në ligjin procedural penal, në ligje të tjera apo akte nënligjore.

Metodologjia e këtij raporti, në përputhje edhe me raportet e viteve paraardhëse, konsiston në mbledhjen e të dhënave statistikore të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në sintezën e këtij informacioni dhe analizën e aspekteve të veçanta në veprimtarinë dhe administrimin e Prokurorisë. Raporti është i organizuar i tillë që të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara në urdhrin nr. 330, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “*Për përmbajtjen e raportit vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë*”.

## **I-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2023**

### **1.1-TË DHËNA PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE PRIORITARE TË PROKURORISË**

Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Lezhë, në zbatim të Kushtetutës, udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 i është dhënë përparësi procedimeve penale në fushën e zgjedhjeve, në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimi me detyren nga nënpunësit shtetëror, në fushën e veprave penale kundër jetës së personit dhe moralit, veprat penale kundër mjedisit etj. Intensifikimi i përpjekjeve nga prokurorët për të berë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmerise së veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe marrjen në përgjegjësi penale të subjekteve përkatëse, si në pastrimin e produkteve të veprës penale, vjedhjet etj, te cilat jane më të ndjeshme për shoqerine tonë. Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policise gjyqesore. Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit, me qëllim për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave për rritjen e cilësisë së punës. Respektimi nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore i detyrimeve të ligjit procedural penal, urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe atyre të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Rritja e profesionalizimit të prokurorëve në hetimin paraprak, në marrjen e vendimeve përfundimtare, në paraqitjen e kërkesave para gjyqtarit të seancës paraprake dhe në mbrojtjen e akuzës në gjykim si dhe ruajtjen e etikës dhe disiplinës në punë. Administrimi/koordinimi nga vetë Drejtuesi i Prokurorisë Lezhë i sistemit elektronik e-tracking PRESTO, për hedhjen e të dhënave të përditësuara për çështjet e regjistruara për vitin 2023 e në vijim dhe çështjet e mbartura me 1 janar 2022 e në vijim, për veprat penale të pastrimit të parave në zbatim te urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në përmbushje të planit të veprimit ICRG/FATF, ne kuadrin e integritimit european të vendit.

### **1.2-RRITJA E ROLIT AKTIV TË PROKURORIT DHE HETIMET PROAKTIVE**

Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Lezhë, në varësi të natyrës së veprës penale, janë zhvilluar hetime proaktive, disa prej të cilave kanë rezultuar të suksesshme. Kryesisht, janë zhvilluar hetime proaktive për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, shfrytëzimi i prostitucionit, vrasjeve, plagosjeve të rënda me dashje etj, duke përdorur kryesisht metodat hetimore të përgjimit telefonik dhe vëzhgimit ambiental. Nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2023 janë bërë 45 kërkesa për lejim përgjimi, të cilat janë pranuar nga Gjykata e Shkallës Së Parë Lezhë. Gjithashtu janë bërë 5 kërkesa për kontroll banese, të cilat janë pranuar plotësisht nga ana e gjykatës.

### **1.3-INFORMACION MBI ZBATIMIN E UDHËZIMEVE TË PËRGJITHSHME TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Me qëllim zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Lezhë janë hartuar, përveç masave konkrete të marra për zbatimin e tyre, si mbledhja e prokurorëve dhe diskutimi tyre, udhëzimet dhe urdhrat e mëposhtëm:

- **Udhëzim nr. 11 datë 06.10.2023 “Mbi sistemin e integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të Mitur”** i nxjerrë në mbështetje të të nenit 52, pika 1 dhe 3, të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” , Vendimit të Këshillit të Ministarve nr.149, datë 20 mars 2019 “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e detyësore dhe dhënësin e informacionit të Sistemit të Integruar të të Dhenave të Drejtësisë Penale për të Mitur” si dhe Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 87 datë 28.07.2022 “Për miratimin e rregullave për përdorimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Udhëzim nr. 8 datë 26.05.2023 “Për miratimin e planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, i nxjerrë në mbështetje të të nenit 52, pika 1 dhe 3, të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

### **1.4-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REZOLUTËS SË KUVENDIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË SAJ**

Në kuadër të rezolutës së mësipërme, vlerësoj se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të parashtruara në rezolutën e Kuvendit janë përmbushur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë në përputhje me juridiksionin e saj dhe kompetencën lëndore e territoriale :

- Rritja e rolit aktiv të prokurorëve që të ushtrjnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe të evidentohen rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore. Në këtë kuadër nga ana e prokurorëve është rritur ndjeshëm kontrolli mbi punën e oficerëve të policisë gjyqësore ku rezulton të kemi patur edhe raste ku prokurori është drejtuar me kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj një oficeri të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
- Marrja e masave efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje e veprave penale ndaj të miturve dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet shtetërore që

- ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi. Forcimi i kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet, si dhe për hetimin e rasteve të dhunës në familje. Përa si përket kësaj pike nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Lezhë janë marra hapa konkret në këtë drejtim ku janë organizuar takime të përbashkëta si dhe janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organet vendore në të cilat ushtron juridiksionin territorial kjo prokurori.
- Vijimi i punës për vlerësimin e kapaciteteve profesionale, teknologjike dhe marrjen e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe ndërlidhjes duke bashkëpunuar me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Përsa i përket kësaj pike rezulton nga prokuroria janë bërë përpjekjet maksimale për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknologjike gjithnjë duke patur në konsideratë mbështetjen financiare si dhe infrastrukturën në dispozicion.
  - Vijimi i punës së nisur për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse. Edhe përsa i përket kësaj pike është nga prokuroria ka patur një angazhim maksimal për plotësimin dhe harmonizimin e të dhënave të këtij sistemi. Lidhur me funksionimin dhe përfitimin e të dhënave nga ky sistem kërkohen krahas kapaciteteve infrastrukture edhe kapacitete njerëzore.
  - Përditësimin e manualit për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve në kuadrin e projektit FIIAPP. Të rritet efektiviteti i hetimeve financiare. Të trajnohen policia dhe prokurorët për të përmirësuar teknikat e hetimit financiar. Të rritet efektiviteti i hetimeve për çështjet e pastrimit të parave dhe të krijohet bashkëpunimi institucional ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme dhe zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm për çështjen e monedhave të falsifikuara në vend. Për sa i përket kësaj pike kanë marrë trajnime pranë shkollës së Magjistraturës prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, trajnime të cilat kanë rritur njohuritë e tyre qoftë për kuadrin ligjor, si dhe për teknikat më të mira për hetimin e këtyre grup veprave penale.
  - Të raportohet mbi gjetje, problematika dhe rekomandime për zbatimin e hartës së re gjyqësore brenda muajit dhjetor. Përsa i përket kësaj pike rezulton se, në zbatim të hartës së re gjyqësore Prokurorisë Lezhë i është bashkuar edhe Prokuroria Kurbin. Si pasojë e këtij bashkimit rezulton se, janë vënë re një sërë problematikash në praktikë. Këto kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e ambienteve për akomodimin e stafit si dhe funksionimin e institucionit në tërësi. Po kështu një problematikë tjetër konstatohet në mungesën e unifikimit, të të dhënave të regjistrave apo të dhënave të sistemit Cams etj.
  - Aksesin e drejtpërdrejtë në regjistrin elektronik të abonentëve celularë dhe adresat IP nga ana e ofruesve të shërbimit të internetit (jo vetëm në 40 regjistrat kombëtarë) për lehtësimin e hetimeve. Përsa i përket kësaj pike dhënia e aksesit në këto regjistra do ndikonte shumë në shpejtësinë e hetimeve.
  - Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira (agjencitë ligjzbatuese, prokuroria dhe sistemi gjyqësor) për rastet e trafikimit të armëve të zjarrit. Përsa i përket kësaj pike rezulton se, gjatë vitit 2023 ka patur një shkëmbim informacioni me organet e tjera ligjzbatuese të cilat kanë ndikuar në goditjen e rasteve të trafikimit, mbajtjes së armëve.

- Të rriten kapacitetet institucionale dhe profesionale në prokurori, si dhe bashkëpunimi ndërinstytucional nëpërmjet përdorimit të rrjetit të pikave të kontaktit, të ngritur në zbatim të Konventës së KiE-së për krimin kibernetik për të rritur efektivitetin në luftën kundër krimin kibernetik dhe mashtrimin në internet. Përsa i përket kësaj pike gjithashtu kemi patur bashkëpunime në hetimin e këtyre grupverpave penale por për shkak të evolimit të shpejtë të teknologjisë rezultoi e vështirë ndjekja dhe hetimi në kohë reale i këtyre veprave.
- Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në lidhje me kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, si dhe për shkelje individuale të magjistratëve. Përsa i përket kësaj pikë nga prokuroria ka patur bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë lidhur me rastet e inspektuara.

### **1.5-INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE UDHËZIMEVE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në kuadër të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave vlerësoj se jemi përpjekur për përmbushjen e prioriteteve të parashikuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave. Në këto të fundit, ndër prioritetet janë, garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit, lufta ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar, respektimi i të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimi ndërinstytucional.

Në vitin 2023, në kuadër edhe të rekomandimeve, zbatimit të tyre me prioritet nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë regjistruar rreth 21 procedime penale të reja për veprën penale “Shpërdorim detyrë”.

- Janë zhvilluar hetime proaktive në drejtim të ndjekjes penale të veprave penale të “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Korrupsionit pasiv të zyrtarëve publikë”, parashikuar nga nenet 248 dhe 259 i Kodit Penal, kryesisht duke përdorur format e përgjimit telefonik dhe vëzhgimit ambiantal, në pjesën më të madhe të procedimeve të mësipërme penale dhe kur është vlerësuar e arsyeshme që një teknikë e tillë hetimi mund të jepte rezultate provuese në hetim. Referimet lidhur me këtë vepër penale janë kryer kryesisht nga seksioni kundër krimin financiar në DVP Lezhë.
- Në disa prej rasteve nga ana e prokurorëve ka pasur edhe rezultate konkrete, ku në bazë të hetimit të kryer ka rezultuar e provuar kryerja e veprave penale. Në raste të tjera, është konkluduar mbi vepra të tjera penale, konkretisht, ajo e shpërdorimit të detyrës. Konkretisht, në dy procedime penale është vendosur mbi kërkesën e prokurorisë pezullimi nga detyra i 13 punojësve të Ashk Lezhë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.
- Lidhur me masat e sigurimit, nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është ndjekur një politikë e ashpër penale, në përputhje me rekomandimet prioritare, të cilat kërkojnë ashpërsimin e politikës lidhur me masat e sigurimit dhe dënimit të autorëve të këtyre veprave penale. Ky qëndrim i organit të akuzës



ka gjetur mbështetje nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

- Lidhur me aksesin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në databazat shtetërore mundësohet lidhja nga ana teknike, por aksesit që jepet nuk është në nivelin e duhur për të nxjerrë informacionin e kërkuar. Aktualisht, është në funksion dhe është përmirësuar sistemi lidhur me administrimin e çertifikatës elektronike të gjendjes gjyqësore, E-Albania, Tims, ASHK (të dhënat e hedhura nga ASHK nuk janë të plota dhe pavarësisht aksesit nuk kanë ndihmuar shumë në punën tonë).
- Lidhur me rastet e hetimeve pasurore, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka aktualisht në hetim nga viti 2021, 40 materiale të cilat janë në fazën e hetimit pasuror. Në vitin 2023 janë regjistruar vetëm 3 referime pasurore të cilat janë referuar 2 nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë dhe 1 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Aktualisht këto materiale janë në fazë hetimi.
- Përgjatë vitit 2023, ka vijuar të mbetet problematike mungesa e referimeve për veprën penale të korrupsionit nga ana e institucioneve të tjera ligjzbatuese, të cilat kanë detyrën funksionale të mbledhjes së informacioneve në këtë drejtim, siç mund të jetë Policia e Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave apo dhe institucione të tjera si Drejtoria e Hetimit Tatimor rajoni Shkodër etj. Gjatë vitit 2023 janë referuar 4 materiale, 2 nga DVP Lezhë 2 nga Agjencia e Mbykqyrjes Policore.
- Në drejtim të forcimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në periudhën raportuese kanë munguar trajnimet e përbashkëta me agjensitë ligjzbatuese të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve në luftën kundër krimit të organizuar, theksojmë se:

- Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë zhvilluar dhe janë në zhvillimin e sipër hetime të procedimeve penale për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si edhe prodhimit dhe shitjes së narkotikëve etj. Aktualisht, janë dërguar në gjykim **21** procedime penale me **38** të pandehur nga të cilët **15** me masë sigurimi “Arrest ne burg” për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, duke përfshirë në këtë të dhënë edhe dosjet e mbartura prej viteve të kaluara dhe dosjet e reja të vitit 2023. Është dhënë vendim fajsie për **28** persona.
- Lidhur me veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, përgjatë vitit 2023 janë regjistruar **18** procedime penale të reja dhe në total sëbashku me të mbartuarat **41** procedimi. Për sa i përket të dhënave statistikore për këtë vepër penale, janë dërguar për gjykim **1** çështje me **1** të pandehur, **3** çështje, duke përfshirë të rejat dhe të mbarturat, janë dërguar në gjykatë me kërkesën për pushim, rastet e tjera pra **30** çështje janë në hetim. Ashtu siç e kemi theksuar edhe në raportimet e mëparshme, vështirësia qendron në faktin se një pjesë e të dhënave hetimore është e nevojshme të përftohen nëpërmjet letërporosive

në shtete të tjera, çka shkakton vonesa në hetimin e këtyre procedimeve penale, duke mos pasur në këtë mënyrë një impakt të shpejtë në ndjekjen e kësaj kategorie vepr penale.

- Edhe sa u përket rekomandimeve në këtë fushë, vlerësohet e nevojshme rritja e numrit të trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore si dhe aksesit në të dhënat e sistemeve qeveritare.
- Lidhur me rekomandimet në luftën kundër krimit të organizuar dhe veprimtarive të tyre, sa i përket hetimeve, hetimeve pasurore, proaktive, bashkëpunimit ndërinstitucional etj., nuk disponojmë të dhëna për shkak të mungesës së kompetencës mbi këtë lëndë.
- Edhe në këtë rubrikë, ashtu si në rubrikën e mësipërme, të rekomandimeve prioritare në fushën e luftës ndaj korrupsionit, konstatohet mungesa e aksesit në database shtetërore dhe mungesa e trajnimeve të përbashkëta me qëllim përmirësimin profesional në ushtrimin e ndjekjes penale për veprat penale të narkotikëve dhe pastrimit të parave.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut, nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore kryhen vazhdimisht përpjekje për zbatimin e tyre duke patur gjithnjë në fokus kategoritë vulnerabël që për arsye të ndryshme, bëhen pjesë apo palë të një procesi penal, veçanërisht të miturit, gratë, personat e dhunuar dhe ata me aftësi ndryshe.

- Është mbajtur në konsideratë që për veprat penale dhe autorët me rrezikshmëri të ulët shoqërore, të kërkohen përpara gjykatës zbatimi i dënimeve alternative, ku kryesisht është aplikuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe vënia e të pandehurit në provë për një periudhë të caktuar, duke mbajtur kontakte me shërbimin e provës.
- Përgjatë vitit 2023 kemi **12** raste të aplikimit të masës së shmangies nga procedimi penal për të miturit autorë të veprës penale.
- Është treguar kujdes lidhur me aplikimin e masave të sigurimit shtrënguese për të miturit autorë të veprave penale. Në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, caktimi i masave të sigurimit shtrënguese për të miturit është konsideruar si masë e fundit, vetëm nëse çdo masë tjetër e parashikuar në këtë Kod nuk është e përshtatshme.
- Janë bërë përpjekje për zhvillimin e hetimeve të shpejta në rastet e çështjeve ku të miturit janë viktima ose autorë të veprave penale. Në këtë drejtim, duhet të mbahet në konsideratë jo vetëm kohëzgjatja e procedurës së hetimit nga ana e prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore, por edhe kërkesat eventuale të palëve gjatë procesit të hetimit dhe sjellja e tyre.
- Në përputhje me rekomandimet prioritare, janë ashpërsuar kërkesat për aplikimin e masave të sigurimit dhe dënimeve ndaj autorëve të veprave penale të ngacmimit seksual, përndjekjes, dhunës në familje etj.
- Vlerësohet se është e nevojshme realizimi i trajnimeve sidomos me oficerë të policisë gjyqësore por edhe prokurorë me qëllim përmirësimin e zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

## **1.6-RESPEKTIMI I TË DREJTAVE DHE INTERESAVE TË LIGJSHME TË SHTETASVE NË PROCESIN PENAL**

Nga ana e Prokurorëve dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë gjatë vitit 2023, në ushtrimin e funksioneve të tyre, rëndësi të veçantë i kanë kushtuar respektimit të të drejtave themelore të njeriut, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, në mbrojtje të të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, ashtu edhe të të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve dhe të dënuarve. Kodi i Procedurës Penale i ka dhënë statusin e subjektit të procedimit penal viktimës së veprës penale.

Në këtë aspekt respektimi i të drejtave të viktimave të krimit në përgjithësi, dhunës në familje, dhunës seksuale, ndihma ndaj personave me aftësi të kufizuara kur janë pjesëmarrës në procedim, etj, kërkojnë angazhim dhe thellim të njohurive jurisprudenciale dhe doktrinare, në funksion të rritjes së vazhdueshme profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Ajo që duhet theksuar është nevojja për përmirësim të infrastrukturës së institucionit të prokurorisë, si dhe burimeve njëzëzore. Në zbatim të standarteve më të lartë për viktimat e mitur duhet të krijohen një zyrë e posaçme e përshtatshme për praninë e tyre.

Nga ana e prokurorëve në procesin penal janë mbajtur parasysh vecanërisht të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve dhe detyrimet ndaj tyre, në kuadrin e risive që legjislacioni procedural penal ka njohur. Prokurori, oficeri i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë kanë mbajtur në vëmendje nevojën për privatësi të viktimave dhe dëshmitarëve vecanërisht në çështjet penale me të mitur.

Gjatë përmbushjes së detyrës së tyre prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë vepruar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventen për të Drejtat Themelore të Njeriut, si dhe ligje të tjera që garantojnë këto të drejta.

Gjatë vitit 2023 nuk ka patur apo janë evidentuar raste të shkeljes apo cënimit të këtyre të drejtave.

Gjatë të gjithave fazave të procesit penal janë respektuar të gjitha detyrimet proceduriale dhe ato që kanë lidhje me të drejtat e njeriut. Nuk ka patur zgjatje të pajustificuara të hetimit.

Zgjatja e afateve të hetimeve paraprake për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 ka qënë si më poshtë:

Deri në tre muaj: 30 çështje me 41 të pandehur, 16 arrest në burg.

Mbi tre muaj deri në gjashtë muaj: 7 çështje me 7 të pandehur, 5 arrest në burg.

Mbi gjashtë muaj deri në nëntë muaj: 4 çështje me 6 të pandehur, 1 arrest në burg.

Mbi nëntë muaj deri në një vit: 2 çështje me 2 të pandehur, 2 arrest në burg.

Mbi një vit: 1 çështje me 1 të pandehur.

Në lidhje me zgjatjet e afateve të hetimeve paraprake nuk janë bërë ankime në gjykatë lidhur me zgjatjet e afateve hetimore.

Janë respektuar dispozitat proceduriale që parashikojnë të drejtat e palëve në procesin penal. Janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar kërkesat apo memot e bëra me shkrim që palët kanë paraqitur gjatë hetimit paraprak.

Për institucionit tonë nuk ka patur ndonjë rekomandim por vetëm një kërkesë të bërë nga Avokati i Popullit për vitin 2023. Gjatë ushtrimit të funksioneve për vitin 2023 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka përmbushur detyrimin ligjor duke dhënë në kohë informacion për sa është kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

## **1.7-TË MITURIT DHE GRUPET VULNERABËL , TË PANDEHUR DHE VIKTIMA**

Përgjatë vitit 2023, vlerësoj se Prokurorët kanë mbajtur në konsideratë të drejtat e këtyre grupeve të veçanta shoqërore, si të miturit dhe gratë, si në rastin kur mund të kenë pasur cilësinë e të pandehurit/personit nën hetim, ashtu edhe nëse kanë qenë viktime të ndonjë vepre penale. Për këtë vit, nga statistikat rezulton se të pandehurit e mitur janë kryesisht të përfshirë në veprat penale të “*Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt*”. Në çështjet penale, ku autori i mitur është zbuluar pasi ka ndodhur vepra penale, prokurorët kanë orientuar oficerët e policisë gjyqësore, që të procedohet në përputhje me **“*Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur*”**, duke u treguar të kujdesshëm me masat kufizuese të lirisë, që ato të jenë në përputhje me direktivat që përmban ky kod, që në veprime procedurale me të miturin, të garantohet asistencë detyrimisht e mbrojtësit, psikologut, familjarit, si edhe në marrjen e masave për njoftimin e organeve vendore që kanë si kompetencë të tyre trajtimin social të të miturve. Sa i përket të miturve viktime apo deklarues, sërish nga ana e prokurorëve është orientuar që veprimet procedurale me këta shtetas të kryhen në praninë e psikologut dhe nëse ka qenë rasti, edhe të prindërve. Me të njëjtën rëndësi dhe vëmendje janë trajtuar rastet e grave, veçanërisht ato që janë viktime të një vepre penale. Megjithatë, në rastet e femrave dhe grave, aktualisht paraqitet problematike numri i ulët i oficerëve femra të policisë gjyqësore, të cilat janë të domosdoshme në rastet kur kodi i procedurës penale përcakton se viktime e dhunës seksuale ose ato të trafikimit mund/duhet të pyetet nga një oficer i së njëjtës gjini.

Përpos këtyre kategorive, nga ana e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore një vëmendje e veçantë u është kushtuar të moshuarve, personave me dëmtime fizike (*të pandehur ose viktime*), si edhe viktimave të dhunës në familje ose dhunës seksuale. Kjo vëmendje ka konsistuar në kryerjen e veprimeve hetimore të shpejta, të gjithanshme dhe dinamike, si edhe mbajtjen në konsideratë të një politike të drejtë dënimesh në rastet e këtyre të pandehurve.

Me qëllim garantimin e të drejtave të të gjitha subjekteve të procedimit penal, me fokus të miturit dhe viktimat e dhunës në familje, si një garanci e shtuar lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përgjatë procesit penal, është e domosdoshme që ndryshimet e

rëndësishme ligjore të njihen dhe të zbatohen nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët. Është e nevojshme rritja e profesionalizmit nëpërmjet trajnimeve specifike dhe përbushja e detyrimeve ligjore prej tyre nëpërmjet zbatimit korrekt të ligjit.

## 1.8-BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur raporte korrekte me institucione të tjera, në zbatim të ligjit procedural, ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e organeve përkatëse dhe atij organik për Prokurorinë Shqiptare. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

- Prokurorinë e Përgjithshme, me të gjitha drejtoritë, e organizuara pranë Prokurorisë së Përgjithshme;
- Me Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
- Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë.
- Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Omn.
- Strukturat e Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë dhe Komisarariatet Lezhë, Mirditë, dhe Kurbin, që ushtrojnë funksionet në territorin ku shtrin kompetencat Prokuroria Lezhë;
- Me të gjitha institucionet e tjera që kanë organizuar shërbime të policisë gjyqësore, dhe kanë referuar materiale hetimore në Prokurorinë Lezhë;
- Me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për fazën që lidhet me kërkimet e bëra gjatë hetimit paraprak, në seance paraprake, me përfaqesimin e akuzës në gjykim, etj;
- Me Prokurorinë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për fazën që lidhet me çështjet penale të ankimuar;
- Me IEVP – Shënkollë, Lezhë;
- Me IEVP – Reç, Malësi e Madhe;
- Me Zyrën e Shërbimit të Provës;
- Me Zyrën e Përmbarimit
- Me Institucione të tjera në nivel lokal.

Gjatë gjithë vitit 2023, ka patur një marrëdhënie shumë të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë dhe sektoret e Prokurorisë së Përgjithshme dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Gjatë vitit 2023, përveç respektimit me rigorozitet të detyrimeve ligjore dhe në funksion të rritjes së cilësisë së hetimit paraprak, është synuar edhe krijimi i një raporti të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha strukturat e policisë së shtetit që veprojnë në qarkun e Lezhës, si Drejtoria e Policisë së Qarkut dhe Komisarariatet e Policisë Lezhë Kurbin dhe Mirditë, strukturat e policisë rrugore. Rritjes së bashkëpunimit i ka shërbyer edhe institucionalizimi i takimeve të përbashkëta periodike ndërmjet drejtuesit të kësaj Prokurorie dhe drejtuesve të efektivave policore

që disponojnë shërbimet e policisë gjyqësore. Megjithatë, në tërësi vlerësoj se ende ka nevojë që bashkëpunimi me strukturat e policisë të përmirësohet dhe institucionalizohet, pasi ky bashkëpunim kondicionohet edhe nga lëvizjet e shpeshta strukturore dhe transferimet e strukturave vendore të Policisë, kualifikimet e tyre në fushën e legjislacionit procedural penal, faktit që janë në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme etj.

Lidhur me raportet e Prokurorisë me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, vlerësoj se kanë qenë korrekte dhe ligjore, si në kërkesat që lidhen me fazën e hetimit paraprak, ashtu dhe atë të seancave paraprake, të gjykimit të proçedimeve dhe përfaqësimit të akuzës në gjyqë. Prokurorëve u është kërkuar respektimi me korrektesë i pjesëmarrjes së tyre në gjykim, çka realisht është përmbushur në mënyrë konkrete.

Gjatë vitit 2023 ka vijuar komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me Prokurorinë e Apelit Tiranë, në funksion të përfaqësimit sa më cilësor të akuzës në çështjet e ankimuarra dhe me njoftimin e vendimeve apo akteve të cilat kanë ekzekutim të menjëhershëm, apo ato akte të cilat kanë karakter ngutshëm.

Nga ana e Prokurorisë Lezhë është treguar gatishmëri e plotë për të bashkëpunuar edhe me institucione të tjera si Prefekti i Qarkut Lezhë, Bashkitë e qarkut të Lezhë (Lezhë, Kurbin dhe Mirditë), në aktivitete që i shërbejnë parandalimit të përhapjes së veprave penale, sikurse janë ato në fushën e ndërtimeve pa leje, kultivimit të lëndëve narkotike, dhunës në familje, etj. Përgjithësisht, raportet me institucionet e tjera qëndrore e vendore kanë qenë korrekte dhe institucionale.

Lidhur me bashkëpunimin me institucione të tjera të pavarura si ILDKPKI, KLSH, Avokati i Popullit etj, konstatojmë se për gjatë vitit 2023 nuk ka patur kallëzime penale nga këto institucione.

## **1.9-BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

Me qëllim bashkëpunimin e efektshëm në ushtrimin e ndjekjes penale apo marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, lidhur me veprat penale që kanë kryer shtetasit shqiptarë jashtë shtetit, apo shtetasit e huaj në qarkun e Lezhës, nga ana e Prokurorisë Lezhë janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dy organet kompetente që mundësojnë ndërmjetësimin e bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

### **1.10-TË DHËNA LIDHUR ME TRAJNIMET E PROKURORËVE DHE OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE**


Për shkak të ngarkesës tejet të lartë të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka qenë e kufizuar ndjekja e vazhdueshme e trajnimeve në kuadër të trajnimeve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Trajnimet që janë ndjekur kanë qenë ato të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme dhe partnerët

si Euralius, Opat etj. Prokurorët e Prokurorisë Lezhë për gjatë vitit 2023 kanë marë pjesë për trajnimet me temat “Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i veprave të pastrimit të parave, përfshirë ceshtjet e lidhura me korrupsionin”, “Rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale (mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, zbatimi i urdhërit, ushtrimi i një të drejte apo përmbyshja e detyrës.”, “Korrupsioni si vepër penale në sektorin publik dhe privat”, “Masat e sigurimit ndaj të miturit në konflikt me ligjin”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive në kuader të ligjit "Per parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nepermjet masave parandaluese kunder pasurise", “Përgjegjësia penale e personave juridikë”, Kontrolllet dhe sekuestrimet si mjete të kërkimit të provës”, Kufijtë e veprimtarisë/kopetencat e gjyqtarit të hetimit paraprak”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive”, “Rishikimi i vendimeve penale, risitë”, Llojet e masave të shmangjes ndaj të miturit”, “Afatet e paraburgimit, etj...

## **II-ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE TË PUNËS SË PROKURORISË**


### **2.1-VOLUMI I PUNËS NË HETIM**

Pranë kësaj Prokurorie, gjatë vitit **2023** janë **regjistruar** gjithsej të reja **1381** (duke llogaritur këtu edhe **98** procedimet penale të regjistruara nga ish – Prokuroria Kurbin për periudhën kohore 1 Janar 2023 – 01.05.2023. Nga të dhëna të përgjithshme, rezulton se gjatë vitit **2023** (duke përfshirë procedimet dhe mosfillimet) në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, janë **referuar** gjithsej **1775** materiale hetimore të reja, për të cilat për **1381** prej tyre është vendosur regjistrimi i procedimit penal, për **636** prej tyre është vendosur mosfillimi i procedimit penal dhe pjesa tjetër është në fazë verifikuese. Nga viti **2022**, janë **mbartur** gjithsej **557** procedime penale, me **223** persona në hetim/pandehur prej të cileve **30** të arrestuar. Në vitin **2023**, duke përfshirë tashmë edhe çështjet e mbartura, është ushtruar ndjekja penale në hetimin paraprak për **1940** procedime penale.



- ✓ *Krahasuar me vitin 2022, këtë vit konstatohet një rritje e procedimeve penale të regjistruar të reja, dhe konkretisht, 416 të tilla. Po kështu kemi edhe një rritje prej 298 të numrit total të referime. Në vitin 2022 janë referuar 1477 materiale hetimore ndërsa në vitin 2023 janë referuar 1775 materiale hetimore. Kjo lidhet dhe me shkrirjen e ish – Prokurorisë Kurbin ku materialet e kësaj prokurorie referohen nga muaji Maj 2023 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiskionit Lezhë. Përsëri ngarkesa e prokurorëve vijon të jetë e lartë edhe pse kemi rënie të numrit të procedimeve.*

- **Grafiku për vitet 2022 dhe 2023**






	Procedime	Mosfillime	Materiale total	Te mbartura	Ngarkesa efektive
Viti 2022	965	460	1618	653	2271
Viti 2023	1381	636	1775	557	2332

## 2.2-ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

Duke përfshirë edhe procedimet e mbartura në gjykim nga vitet e kaluara, gjatë periudhës një vjeçare prokurorët janë paraqitur për të mbrojtur akuzën në gjykatë për **319** procedime penale, me **343 të pandehur**, nga të cilet **44** janë gjykuar nën masën e sigurimit «**arrest në burg**».

## 2.3-TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË

- Në vitin **2022**, janë **mosfilluar** gjithsej **460** materiale hetimore penale.




- Gjatë vitit 2022, janë **pushuar/dërguar për pushim** gjithsej 278 procedime penale, nga të cilat:
  - 131** procedime të pushuara për krime me kërkesa për pushim në gjykatë dhe
  - 147** procedime janë pushuar me vendim të prokurorit pasi janë kundravajtje penale
 Nga këto:
  - 267** procedime për **mungesë të faktit** penal,
  - 2** procedime për mungesë prove
  - 9** procedime për shkaqe **të tjera procedurale**, ndër më kryesoret e të cileve heqjet dore nga të dëmtuarit për veprat penale që ndiqen mbi ankim.

Në procedimet penale të pushuara :


Eshtë **pushuar** ndjekja penale për **71** persona nën hetim, nga të cilët **0** kanë qënë të arrestuar.

- Gjatë vitit 2022, janë **pezulluar** gjithsej **224** proçedime penale, të gjitha këto për shkak se nuk është bërë e mundur të zbulohet autori i veprës penale.
- Gjatë vitit **2022**, janë **transferuar** gjithsej **12** proçedime penale, me **9** persona nën hetim, nga të cilët 2 me masë sigurimi «**arrest në burg**».
- Në vitin 2022, janë **dërguar për gjykim** gjithsej **499** procedime penale, me **567** persona **të pandehur**. Ndër të pandehurit, **103** prej tyre kanë qënë me masë sigurimi arrest në burg, kurse pjesa tjetër janë ndjekur me masa të ndryshme sigurimi.

- **Të dhënat e pasqyruara në grafik.**




- Në vitin **2023**, janë **mosfilluar** gjithsej **636** materiale hetimore penale.



- Gjatë vitit 2023, janë **pushuar/dërguar për pushim** gjithsej 346 procedime penale me 69 persona nën hetim, nga të cilat:  
**242** procedime me 55 personan nën hetim të pushuara me kërkesa për pushim në gjykatë.  
**104** procedime me 14 persona nën hetim janë pushuar me vendim të prokurorit pasi janë kundravajtje penale.  
 Nga këto:  
**277** procedime për **mungesë të faktit** penal,  
**4** procedime për mungesë prove  
**63** procedime për shkaqe të tjera procedurale, ndër më kryesoret e të cileve heqjet dore nga të dëmtuarit për veprat penale që ndiqen mbi ankim etj.
  
- Në procedimet penale të pushuara :  
 Eshtë **pushuar** ndjekja penale për **69** persona nën hetim, nga të cilët **0** kanë qënë të arrestuar.
- Gjatë vitit **2023**, janë **pezulluar** gjithsej **348** procedime penale, të gjitha këto për shkak se nuk është bërë e mundur të zbulohet autori i veprës penale.
- Gjatë vitit **2023**, janë **transferuar** gjithsej **16** procedime penale, me **3** persona nën hetim, nga të cilët 1 me masë sigurimi «**arrest në burg**».
- Në vitin **2023**, janë **dërguar për gjykim** gjithsej **450** procedime penale, me **509** persona të pandehur. Ndër të pandehurit, **81** prej tyre kanë qënë me masë sigurimi arrest në burg, kurse pjesa tjetër janë ndjekur me masa të ndryshme sigurimi.
- Në vitin 2023 janë mbartuar gjithsenj, 780 procedime me 223 persona nën hetim, nga të cilët 3 persona me masë sigurimi «**arrest në burg**».

- Të dhënat e mësipërme të pasqyruara në grafik.



Në vitin 2022 janë përfunduar 65% e procedimeve penale të hetuara, dhe janë mbartur 35%.

- ✓ *Krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 janë përfunduar nga prokurorët rreth 296 çështje penale më shumë, gjithsej 1796 çështje (përfshirë mosfillimet, dërgimet në gjyq, kërkesa për pushim /vendim pushimi, transferime dhe pezullime) vendimmarrje, ndërsa në vitin 2022 janë 1473 vendimmarrje. Kjo e dhënë reflekton intensitetin e lartë të punës së Prokurorëve dhe mangësitë në organikë.*


	Vendimmarrje
Viti 2022	1473
Viti 2023	1796

## 2.4-TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Në çështjet për të cilat është ushtruar ndjekja penale gjatë vitit **2023**, janë hetuar gjithsej, 1940 procedime, **807** persona, nga të cilët **512** persona të **pandehur** dhe **295** persona **nën hetim**. Ndër personat e hetuar **143** persona janë hetuar me masën e sigurimit **arrest ne burg**, kurse të tjerët janë ndjekur me masa të ndryshme sigurimi.

Rezulton se në vitin 2023, **6** çështje penale kanë filluar kryesisht, janë paraqitur **54** kallëzime nga shtetasit, **1684** referime nga policia e shtetit, **15** nga nënpunës publik, **1** nga tatimet, **15** nga polici të tjera.

- Të dhënat mbi referimet të pasqyruara në tabela.



## 2.5-TË DHËNA NË LIDHJE ME MASAT E SIGURIMIT PERSONAL DHE PASUROR


Për vitin **2022**, treguesit e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve, të kryer ndaj shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale, paraqiten si më poshtë:

- Janë **arrestuar në flagrancë** nga policia gjyqësore **288** shtetas.
- Janë **ndaluar me iniciativë** nga policia gjyqësore **15** shtetas.
- Është nxjerrë **urdhër** ndalimi nga **prokurori** për **8** shtetas.
- Është kërkuar nga prokurori caktim mase për **12** shtetas.
- Në 0 rast është disponuar me urdhër lirimi të menjëhershëm nga ana e prokurorit, pasi ka konstatuar arrestimin ose ndalimin si të paligjshëm.
- Eshtë kërkuar në gjykatë vlerësimi i arrestimit ne flagrancë apo ndalimit për **303** persona, ndër të cilët gjykata ka vlerësuar të ligjshëm **të gjithë arrestimet**.

Për vitin 2022, treguesit e kërkesave të prokurorit për masat kryesore të sigurimit, paraqitet si më poshte vijon :


- Nga **prokurori** është kërkuar në gjykatë për **157** persona caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **116** personave,
  - Nga **prokurori** është kërkuar për **23** raste caktimi i masës së sigurimit “**arrest në shtëpi**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj 31 personave,
  - Nga **prokurori** është kërkuar për **7** person caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg me afat**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **3** personave,
  - Nga **prokurori** është kërkuar për 128 persona caktimi i masës së sigurimit “**detyrim për paraqitjen në policinë gjyqësore**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **155** personave.
- **Treguesit e mësipërm të pasqyruar në tabelë viti 2022 :**

### Prokuroria



- **Treguesit e mësipërm të pasqyruar në tabelë viti 2022 :**

### Gjykata



Për vitin **2023**, treguesit e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve, të kryer ndaj shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale, paraqiten si më poshtë:


- Janë **arrestuar në flagrancë** nga policia gjyqësore **312** shtetas.
- Janë **ndaluar me iniciativë** nga policia gjyqësore **2** shtetas.
- Është nxjerrë **urdhër** ndalimi nga **prokurori** për **1** shtetas.
- Është kërkuar nga prokurori caktim mase për **316** shtetas.
- Në 0 rast është disponuar me urdhër lirimi të menjëhershëm nga ana e prokurorit.onstatuar
- Eshtë kërkuar në gjykatë vlerësimi i arrestimit ne flagrancë apo ndalimit për **316** persona, ndër të cilët gjykata ka vlerësuar të ligjshëm **të gjithë arrestimet**.

Për vitin 2023, treguesit e kërkesave të prokurorit për masat kryesore të sigurimit, paraqitet si më poshte vijon :

- Nga **prokurori** është kërkuar në gjykatë për **139** persona caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **115** personave.
- Nga prokurori është kërkuar në gjykatë për **10** persona caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg**” në mungesë, ndërkohë që gjykata ka caktuar këtë masë sigurimi për **10** persona.
- Nga **prokurori** është kërkuar për **21** raste caktimi i masës së sigurimit “**arrest në shtepi**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **32** personave.
- Nga **prokurori** është kërkuar për **2** person caktimi i masës së sigurimit “**arrest në burg me afat**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **3** personave,


- Nga **prokurori** është kërkuar për 153 persona caktimi i masës së sigurimit “**detyrim për paraqitjen në policinë gjyqësore**”, ndërkohë që **gjykata** e ka caktuar këtë masë sigurimi ndaj **160** personave.
- Nga gjykata janë caktuar 2 masa ndaluese si dhe 1 masë sigurimi “garanci pasurore”.
- **Treguesit e mësipërm të pasqyruar në tabelë viti 2023 :**

#### Prokuroria



- **Treguesit e mësipërm të pasqyruar në tabelë viti 2023 :**

#### Gjykata





## **2.6-TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË**

Gjatë vitit **2022**, janë nxjerrë gjithsej **352** urdhëra ekzekutimi. Nga këto **328** urdhëra janë me burgim, **12** dënime plotësuesë, **12** me gjobë. Nga **328** dënime me burgim janë dhënë **228** dënime alternative.

Janë ekzekutuar **315** dënime me burgim, **4** dënime me gjobë, **4** dënime plotësuese. Nga këto ekzekutime, **228** janë dënime alternative, mbaten të paekzekutuar **13** dënime me burgim dhe **8** dënime me gjobë.

Vendime të mbartura të paekzekutuara janë **1** dënim me burgim të përjetshëm, **27** dënime me burgim dhe **32** dënime me gjobë.

Gjatë vitit **2023**, janë nxjerrë gjithsej **400** urdhëra ekzekutimi. Nga këto **359** urdhëra janë me burgim, **4** dënime plotësuesë, **25** me gjobë. Nga **359** dënime me burgim janë dhënë **185** dënime alternative.

Janë ekzekutuar **347** dënime me burgim, **7** dënime me gjobë, **4** dënime plotësuese. Nga këto ekzekutime, **187** janë dënime alternative, mbaten të paekzekutuar **12** dënime me burgim dhe **20** dënime me gjobë.

Vendime të mbartura të paekzekutuara janë **1** dënim me burgim të përjetshëm, **21** dënime me burgim dhe **31** dënime me gjobë.

Gjatë vitit 2023 nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është kërkuar caktimi i masës së sigurimit preventive në 4 raste të cilat janë miratuar nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Këto sekuestre janë kërkuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i K.Penal. Përsa i përket pasurive për të cilat është vendosur sekuestro rezulton se janë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme por nuk mund të përcaktohet saktësisht se sa është vlera reale e tyre.

## **2.7-KRIMINALITETI SIPAS SHTRIRJE TERRITORIALE**

Në procedimet penale të gjykuara gjatë vitit 2023 janë gjykuar **346** shtetas, të cilët janë mbi 18 vjeç. Banues në qytet janë **106** shtetas, ndërsa banues në zonat rurale janë **241** shtetas. Nga të dhënat statistikore rezulton se shtrirjen më të madhe të kriminalitetit e kanë qytetet Lezhë me rrethinat e tij, ndjekur nga Kurbinë me rrethinat e tij, e me pas renditet qyteti Rrëshen me rrethinat e tij.

## **2.8-KRIMINALITETI SIPAS PËRHAPJES SË VEPRAVE PENALE DHE TENDENCAVE TË TYRE**


Lidhur me gjëndjen e kriminalitetit gjatë vitit 2023. Kreu i Dytë i Kodit Penal, **181** çështje me **44** persona nën hetim dhe **57** të pandehur, nga këta **55** janë hetuar me masë sigurimi arrest në burg.

Në lidhje me Kreun e Tretë të Kodit Penal, “Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, janë regjistruar **458** procedime penale me **70** persona në hetim dhe **49** të pandehur, nga këta **5** të hetuar me masën e sigurimit arrest në burg. Kreu i tetë i Kodit Penal, **694** çështje me **129** persona nën hetim dhe **216** të pandehur, nga këta **53** janë hetuar me masë sigurimi arrest në burg.

## **2.9-KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL (KRIME-KUNDRAVAJTJE)**

Bazuar në ndarjen e veprave penale sipas kategorizimit të tyre në krime dhe kundërvajtje penale, krimet paraqesin tendencën më të lartë në vitin 2023 në qarkun e Lezhës dhe konkretisht, 1681 krime e 259 kundravajtje.

- Të hetuara gjithësenj ndarë në krime dhe kundravajtje në %.



## **III-TREGUESIT STATISTIKORË 2 VJECARE TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL**

### **3.2-NË VITIN 2022**

Lidhur me gjëndjen e kriminalitetit gjatë vitit 2022, veprat penale të cilat zënë numrin me të madh të procedimeve penale të hetuara janë veprat penale të parashikuara nga Kreu II-te, Kreu III-të dhe Kreu VIII-te i K.Penal. Më poshtë të dhënat sipas krerëve të Kodit Penal për vitin 2022, të paraqitura dhe me ndihmën e grafikut:

Kreu I- 0 procedime.

Kreu II -te, gjithsej 120 procedime penale.

Kreu III-te, gjithsej 327 procedime penale.

Kreu IV-te, gjithsej 25 procedime penale.

Kreu V- 0 procedime.

Kreu VI – 0 procedime.

Kreu VII – 1 procedime.

Kreu VIII-te, gjithsej 470 procedime penale.

Kreu IX-te, gjithsej 21 procedime penale.

Kreu X-te, gjithsej 2 procedime penale.

Kreu XI – 0 procedime penale.

### **3.1-NË VITIN 2023**

Lidhur me gjëndjen e kriminalitetit gjatë vitit 2023 veprat penale të cilat zënë numrin me të madh të procedimeve penale të hetuara janë veprat penale të parashikuara nga Kreu VIII-të, Kreu III-të dhe Kreu II-të i K.Penal. Më poshtë të dhënat sipas krerëve të Kodit Penal për vitin 2023:

Kreu I - 0 procedime.

Kreu II - 181 procedime penale.

Kreu III - 458 procedime penale.

Kreu IV - 19 procedime penale.

Kreu V - 0 procedime.

Kreu VI – 0 procedime.

Kreu VII – 0 procedime.


Kreu VIII - 694 procedime penale.

Kreu IX - 29 procedime penale.

Kreu X - 0 procedime penale.

Kreu XI – 0 procedime penale.

- Të dhënat e grupveprave sipas krerëve të ndara në %.



Në vitin 2023 janë hetuar 1940 procedime, janë hetuar 807 persona, nga këto janë 295 në cilësinë e personit nën hetim dhe 512 persona janë marrë të pandehur.

Janë dërguar për gjykim 450 procedime penale dhe 512 të pandehur.

## IV-ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË

### **4.1-TREGUESI I EFEKTIVITETIT NË GJYKIMIN DHE NË DENIMIN E TË PANDEHURVE**

Duke përfshirë edhe procedimet e mbartura në gjykim nga vitet e kaluara, gjatë periudhës njëvjeçare ka përfunduar gjykimi për **319** procedime penale me **343** persona të pandehur, për **2** të pandehur është kërkuar pushim çështje, për **21** të pandehur është dhënë pafajësi nga ana e gjykatës për të cilët është ushtruar ankim nga ana e prokurorëve, **44** të pandehur janë gjykuar me masë sigurimi « arrest në burg ». Mbeten në gjykim **216** procedime penale me **263** të pandehur nga të cilët 62 me masë sigurimi « arrest në burg ».


- ✓ *Në këtë vit kemi pothuajse të njëjtat të dhëna. Vlen të theksohet se si pasojë e lëvizje të gjyqtarëve Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të*

*Përgjithshëm Lezhë gjatë vitit 2023 ka patur një numër minimal prej 2 gjyqtarësh në një pjesë të vitit. Në kuadër të hartës së re gjyqësore nga muaji Maj 2023 është bashkuar Gjykatës Lezhë edhe Gjykata Kurbin si dhe në muajin Korrik janë emëruar 6 gjyqtar magistrat fakt i cili ka ndikuar në rritjen e numrit të gjykimeve.*

#### 4.2-TË DHËNA PËR GJYKIMET E POSAÇME

Ndër gjykimet për të cilat ka përfunduar gjykimi në shkallë të parë:

- Me procedurën e **gjyimit të drejtpërdrejtë** janë gjykuar **32** procedime penale.
- Per **297 procedime** penale eshte zhvilluar **gjykim i shkurtuar**,
- Per **0** procedime penale eshte zhvilluar gjykimi ne **mungesë**,
- **0** procedime janë zhvilluar me procedurën e gjyimit të zakonshëm.




- ✓ *Në këtë seksion duhet të mbahet në konsideratë se nuk janë bërë gjykime me marveshje apo asnjë kërkesë për miratim urdhëri penal kjo për faktin se në praktikën e gjykatës ndër vite marveshjet e fajsisë apo urdhërat penal nuk janë miratuar nga gjykata në pjesën dërmuese të rasteve.*

#### 4.3-TË DHËNA MBI LLOJET DHE MASAT E DËNIMEVE


Ndër personat e deklaruar fajtorë në gjykimin në shkallën e parë:

- Nga prokurori është kërkuar dënimi me burgim për **127 persona**, ndërsa gjykata ka dhënë në **114** raste dënim me burgim.
- Nga prokurori është kërkuar dënimi me gjobë për **9** raste, ndërsa nga gjykata është caktuar dënimi me gjobë për **9** raste.
- Për **218** prej të dënuarve nga prokurori është kërkuar aplikimi i dënimit me kusht, ose punë në interes publik, ndërkohë që gjykata e ka aplikuar këtë dënim në **209** raste.
- Në asnjë rast nuk është kërkuar nga prokurori tërheqje akuze.
- Për **1** rast është kërkuar pushim akuze, ndërsa nga gjykata është miratuar në **1** rast tërheqja e akuzës.
- Për **2** raste është kërkuar pushim çështje, ndërsa nga gjykata është miratuar në **2** raste pushimi i çështjes.
- Nga gjykata është dhënë pafajsi për **21** raste të cilat janë ankimuar nga prokurori dhe aktualisht janë në gjykim në Gjykatën e Apelit.
- Të dhënat e mësipërme të pasqyruara në tabelle :

Prokuroria.



- Të dhënat e mësipërme të pasqyruara në tabelle :
- Gjykata.



#### 4.4-TË DHËNA SOCIALE DHE DEMOGRAFIKE PËR TË PANDEHURIT

- Në procedimet penale të gjykuara gjatë vitit 2023 janë gjykuar **346** shtetas, të cilët janë mbi **18** vjeç.
- Nga këta **339** janë meshkuj dhe **7** janë femra.
- Në lidhje me arsimin deri në nëntë klasë janë **231** shtetas. Me arsim të mesëm janë **94** shtetas dhe me arsim të lartë janë **22** shtetas.
- Të papunë janë **136** shtetas.
- Banues në qytet janë **106** shtetas, ndërsa banues në fshat janë **241** shtetas.
- Përsëritës të të njëjtës veprë penale, janë **4** shtetas. Për vepra të tjera penale janë **11** shtetas, ndërsa të padënuar janë **332** persona.

#### 4.5-TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT E MITUR

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë janë regjistruar **40** referime ndër të cilat **28** procedime penale me të mitur. Nga procedimet e regjistruara janë shënuar **30** persona në hetim, nga këta, **2** të grup moshës 14 – 16 vjec dhe **26** të grup moshës 16 – 18 vjec, ku **3** prej tyre kanë qënë me masën e sigurimit arrest me burg. Janë pushuar me shmangie **12** procedime penale me **15** persona nën hetim. Janë pushuar për shkaqe të tjera edhe **5** procedime penale.

#### 4.6-TË DHËNA PËR PASOJAT E VEPRAVE PENALE

Aktualisht, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nuk ka një regjistër të posaçëm apo praktikë dokumentare lidhur me regjistrimin e pasojave të veprave penale. Duke përjashtuar veprat penale formale, për të cilat nuk është e nevojshme ardhja e pasojës, por kryerja e një veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me ligjin penal, në rastet e veprave penale materiale, nisur edhe nga përhapja e gjerë në qarkun e Lezhë, ato që shkaktojnë pasoja, janë kryesisht veprat penale të “Vjedhjes”, “Dëmtime të tjera me dashje”, “Drejtimi i automejteve në mënyrë të parregullt”, të cilat i shkaktojnë këto pasoja në drejtim të pasurisë së individëve apo personave juridikë apo publikë, shënetit të njerëzve si dhe autoritetit të shtetit.

## **V-TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA**

### **5.1-EKSTRADIME, LETËRPOROSI, TRANSFERIME PROCEDIMESH, TRANSFERIME TË DËNUARISH, SHPALLJET/HEQJET NGA KËRKIMI NDËRKOMBËTAR**

Përsa i përket marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, për vitin 2023 të dhënat paraqiten sa vijon:

- Gjithsej, gjatë vitit 2023 janë dorëzuar në Gjykatën e Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, **1** kërkesë për ekstradim për jashtë shtetit dhe 1 kërkesë për ekstradim nga jashtë shtetit.
- Letërporosi për jashtë shtetit janë dërguar **8** kërkesa.
- Letërporosi nga jashtë shtetit gjithsej **4** kërkesa.
- Njohje e vendimeve penale të huaja gjithsej **7** vendime.
- Transferim procedimi **1** rast.
- Shpallje në kërkim ndërkombëtar **3** shtetas.
- Heqje nga kërkimi ndërkombëtar **2** shtetas.


## **VI-TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE**

### **6.1-TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS SË PROKURORËVE**


Gjatë vitit 2023, treguesit e përgjithshëm të volumit dhe cilesisë së punës së kryer nga prokurorët, duke përfshirë edhe çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si më poshtë :

- Ngarkesa në total ndarë sipas prokurorëve në %.







- Dërguar për gjykim ndarë sipas prokurorëve në %.




- Pushuar ndarë sipas prokurorëve në %.




- Pezulluar ndarë sipas prokurorëve në %.




- Transferuar ndarë sipas prokurorëve në %.



- Mosfilluar sipas prokurorëve në %



- Mbartuar ndarë sipas prokurorëve në %.



PROKURORI	Çeshtje gjithsej	Derguar gjyqit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Mosfilluar	Mbartur ne hetim
E.Shehaj	110	19	20	11	1	20	59
F.Ganaj	286	75	47	70	0	98	94
S.Kastrati	394	72	76	60	0	73	186
R.Fishta	124	44	34	40	6	60	0
I.Harka	292	68	55	40	7	90	122
M.Fetau	208	32	12	33	0	78	131
A.Nika	196	44	32	44	1	81	75
B.Shehu	47	26	9	12	0	30	0
I.Sufaj	91	15	9	10	1	50	56
N.Bregu	81	14	7	3	0	37	57
Y.Pjeternikaj	111	41	45	26	0	19	0
<b>Totali</b>	<b>1940</b>	<b>450</b>	<b>346</b>	<b>345</b>	<b>16</b>	<b>636</b>	<b>780</b>


- ✓ *Gjatë vitit 2023 kemi një rritje të ngarkesës totale të prokurorisë. Kjo ka ndodhur për arsye se nga data 1 Maj është suprimuar Prokuroria Kurbin e cila është bashkuar me Prokurorinë Lezhë. Në organikë për vitin 2023 Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka një numër prej 14 prokurorësh ndër të cilët ka patur efektivë përgjatë gjithë vitit 6 prokurorë, nga të cilët 2 janë transferuar në prokurori të tjera, 1 prokuror është pezulluar nga detyra nga shkalla e parë e procesit të vlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve, 2 prokurorë magjistratë të rinj janë caktuar në muajin Korrik 2023, ndërsa pjesa tjetër e organikës nuk është plotësuar akoma.*

Gjatë vitit 2023, treguesit e përgjithshëm të volumit dhe cilësisë së punës së kryer nga Oficerët e policisë gjyqësore, duke përfshirë edhe çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, paraqiten si më poshtë :


## **6.2-TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS SË OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE**

- **O.P.Gj. Alfred Gjoka**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **129** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 89 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 40 procedime penale.
- **O.P.Gj Edison Dullaj**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **161** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 101 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 50 procedime penale.
- **O.P.Gj. Lulash Tusha**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **94** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 72 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 22 procedime penale.
- **O.P.Gj Mimoza Dushkaj**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **220** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 162 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 58 procedime penale.

- **O.P.GJ Rita Ndoka**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **134** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 105 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 29 procedime penale.
  
- **O.P.G F. Xhaja**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **60** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 30 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 30 procedime penale.
  
- **O.P.Gj Nik Ndoca**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **130** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 82 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 48 procedime penale.
  
- **O.P.Gj Erenik Muhametaj**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **130** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 79 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 31 procedime penale.
  
- **O.P.Gj Lumturije Smanaj**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **111** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 90 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 21 procedime penale.
  
- **O.P.Gj Artan Uka**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **150** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 110 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 40 procedime penale.
  
- ✓ *O.P.GJ. A.Uka aktualisht krahas ngarkesës hetimore është i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale.*
  
- **O.P.Gj Andi Deda**, ka hetuar për vitin 2023 gjithsej **82** procedime penale, nga të cilat :
  - Përfunduar - 50 procedime penale.
  - Mbartur në hetim – 32 procedime penale.
  
- ✓ *O.P.GJ. Andi Deda ka filluar punë aktive si OPGJ në Prokurorinë e Lezhës në muajin Maj të vitit 2023, transferuar nga Prokuroria Shkodër.*
  
- Ngarkesa e oficerëve të ndara në %.



- Raporti i çështjeve të hetuara nga oficerët e seksionit/oficerët e policisë në %.



## **VII-INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË**

Gjatë vitit 2023 personeli administrativ i kësaj prokurorie i ka kryer me korrektesë detyrat përkatëse, duke qënë një mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore

në përballimin e ngarkesës në punë dhe krijimin e raporteve korrekte me qytetarët, të cilëve u ofrohen shërbime administrative nga ana e Prokurorisë.

Gjatë vitit 2023, buxheti financiar i Prokurorisë Lezhë është administruar me rigorozitet dhe si pasoje e disiplinës financiare dhe ndihmës gjithëvjetore nga Prokuroria e Përgjithshme për zëra të veçantë të tij, nga ana e kësaj prokurorie janë likuiduar pothuajse të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë, ato për shpenzimet procedurale, të pagesës së mbikohës së punës për prokurorët, etj. Megjithatë, vlerësoj se ky buxhet duhet të rishikohet në të ardhmen për shtimin e tij në zëra të veçantë për një mbarëvajtje më të mirë të punës, duke u nisur nga fakti që nga viti në vit shtohet ngarkesa e punës dhe për rrjedhojë dhe nevojat financiare. Aktualisht mbeten pa marrë pagesë për orët shtetsë punonjësit e administratës (protokolli, rregjistri etj). Përgjatë vitit 2023 janë 8 (tetë milion) lek nga të cilat 6.7 (gjashtë, shtatë milion) lek janë pagesa ekspertësh.

Në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë vlerësoj se marrëdhëniet me median dhe publikun kanë qenë korrekte. Nga ana e Prokurorisë është shprehur gatishmëria për të dhënë informacion subjekteve të interesuar në çdo rast që është gjykuar se nuk çënohet hetimi dhe veprimet procedurale përkatëse. Në respektim edhe të normave Kushtetuese është respektuar e drejta për informim e subjekteve të ndryshme. Në rast të refuzimit të kërkesave për informacione lidhur me çështje konkrete, ato janë argumentuar bazuar në normat procedurale penale mbi ruajtjen e sekretit hetimor. Lidhur me administrimin e dokumentacionit të Prokurorisë, konstatoj se jo vetëm regjistrat, por i gjithë dokumentacioni që administrohet në Prokurori mbahet dhe ruhet rregullisht. Lidhur me mbajtjen e regjistrave, në Prokurorinë e Lezhës është e ngarkuar një sekretare dhe deri më tani nuk konstatohen problematika. Gjithashtu po kjo sekretare akseson hedhjen e materialeve në sistemin CAMS ku nuk janë konstatuar problematika. Përgjatë vitit 2023, vlerësoj se kapacitetet infrastrukturore nuk kanë qenë të mjaftueshme me qëllim realizimin e aktivitetit të Prokurorisë. Kjo për faktin se, në kuadër të reformës është suprimuar Prokuroria Kurbin e cila nga muaji Maj 2023 ushtron kopetencat dhe është pjesë e Prokurorisë Lezhë. Nisur nga ky fakt janë hasur vështirësi në akomodimin e punonjësve si dhe në administrimin e materialeve, fashikujve të përfunduar si dhe provave materiale. Gjatë vitit 2023, në zbatim të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, është mbajtur nga sekretarja pranë drejtuesit të prokurorisë, në të cilin janë shënuar të gjitha kërkesat, informacionet, udhëzimet e përgjithshme dhe të posaçme, dosjet e përfunduara për gjykim, të pushuara, moskompetencë, të pezulluara, të mosfilluara, etj. Janë udhëzuar prokurorët në kontrollin periodik dhe efektiv të punës së oficerëve të policisë gjyqësore në lidhje me dosjet e deleguara prej tyre. Me qëllim kryerjen e hetimeve të plota dhe cilësore dhe shmangien e vonesave dhe zvarritjeve në përfundimin e hetimeve. Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore u është kërkuar të angazhohen drejtpërdrejt në rritjen e tyre profesionale, në plotësimin e formularëve për trajnime dhe seminare dhe për pjesëmarrjen fizike të tyre ose online në trajnimet e realizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë dhe shoqatat e organizatat vendase dhe të huaja duke respektuar edhe fushat specifike ku ata kanë më shumë nevojë. Nga ana tjetër, janë nxjerrë urdhra dhe udhëzime konkrete për çështje të caktuara nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe janë kërkuar informacione në lidhje me çështje konkrete objekt i rekomandimeve të KM. Në rastet kur është vlerësuar se këto detyra dhe objektiva në procedimet penale konkrete janë komplekse, ka zvarritje apo vonesa dhe nuk janë përfunduar me përparësi



nga ana e prokurorëve, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore me përparësi nga ana e oficerëve të çështjeve konkrete është udhëzuar dhe rekomanduar kryerja me prioritet e detyrave të lëna.

Në zbatim të vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 13.04.2023, « Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit në vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm » dhe urdhërit nr. 70 datë 12.05.2023 « Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së, është bërë shpërndarja dhe njohja e këtij plani veprimi dhe zbatimin e tij nga të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Në vijim në mbledhjet e zhvilluara, takimet dhe udhëzimet e dhëna janë diskutuar pikat e këtij plani veprimi, mënyra e zbatimit të tij dhe fazat e zbatimit. Gjithashtu, janë orientuar prokurorët dhe oficerët në zbatimin e drejtëpërdrejtë të tij gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje konkrete, detyrave administrative që janë objekt dhe fokus i VKM nr. 226, datë 13.04.2023 dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Masa konkrete janë marrë edhe në drejtim të nxitjes së prokurorëve dhe shpejtësisë dhe cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe hetimeve në lidhje me të gjitha procedimet penale, por në veçanti me procedimet penale për çështjet e trajtuara në rekomandimet prioritare. Në fazën e hetimeve u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje. Në fazën e gjykimit janë orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe gjykimeve të posacme dhe në pasjen parasysh të masave të dënimit të përshtatshme në rastin e çështjeve objekt të Rekomandimeve.

Janë marrë masa dhe janë udhëzuar edhe oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimeve hetimore të kryera prej tyre, në lidhje me raportimet periodike për veprimet e kryera, si dhe për rritjen e cilësisë së relacioneve të çështjeve të përfunduara dhe shpejtësisë së përfundimit të tyre.

Në lidhje me qarkullimin e brendshëm të akteve është nxjerrë një urdhër nga ana e drejtuesit ku mbahet një regjistër i dorëzimit të materialeve tek secili prokuror dhe oficer i policisë gjyqësore.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë funksionon edhe në zbatim të Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë e cila është hartuar duke marrë në konsideratë edhe parashikimet e urdhërit nr. 120, datë 08.09.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, zbatimi i së cilës ndiqet me shumë kujdes nga ana Drejtuesit të Prokurorisë.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë funksionin pa seksione. Kjo pasi janë një numër i vogël prokurorësh dhe nëse do krijohen seksione është e vështirë ndarja e çështjeve në mënyrë të barabartë. Për hetimin e çështjeve penale me të mitur janë caktuar dy prokuror me urdhërin nr. 11 datë 06.10.2023.

Sqarojmë se në Prokurorinë Lezhë çështjet ndahen sipas shortit elektronik. Shortin elektronik e hedh sekretari i regjistrimit nën mbikqyerjen e drejtuesit të prokurorisë. Në çështjet me të arrestuar për shkak të veprimeve të para hetimore dhe afateve prekluzive procedurale çështja i kalon prokurorit të gatshëm. Është mbajtur në funksion sistemi elektronik i ndarjes dhe menaxhimit të

çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), duke bërë pasqyrimin e saktë në sistem të shortit dhe në vijim të fazave të tjera të procedimit penal. Së fundmi edhe çështjet që duhen rishortuar pas largimeve për arsye të ndryshme të cituara në këtë raport, të prokurorëve, është përdorur sistemi CAMS në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu, është kërkuar përgjegjshmëri në hedhjen dhe nxjerrjen e statistikave nga zyra e regjistrarit. Janë përjashtuar dhe nuk janë hedhur në short elektronik në sistemin Cams vetëm çështjet e udhëzuara në udhëzimin nr. 3 viti 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Zyra e Regjistrarit e përbërë nga 1 person i vetëm që mbulohet nga një sekretar, i cili është e ngarkuar me administrimin e regjistrave fizik dhe elektronik, shortin manual dhe elektronik, sistemin CAMS. Gjithashtu është e angazhuar në procesin e vetingut/ kërkesave për verifikim në zbatim të V.K.M-së 188 datë 04.03.2015 për pasjrisjen më çertifikata sigurie, verifikimin për kërkesat për ekstradim, e të tjera që kanë të bëjnë me detyrën funksionale të kryesekretares, në zbatim të Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Zyra e Protokollit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë mbahet nga një sekretare e cila ka ushtruar funksionin e saj sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ku janë regjistruar mbi 17037 praktika/lëndë, pa fraksione, të cilat kanë më shumë se një nënlëndë. Sekretarja për protokollin mban dhe regjistrin e provave materiale.

Arkivi i institucionit mbahet nga sekretari për arkivin, i cili ka ushtruar funksionin e tij sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ku merret me administrimin e arkivit, merr në dorëzim dhe inventarizon të gjitha praktikat e mbyllura të vitit paraardhës.

Specialisti i Teknologjisë së Informacionit, i cili mbulon si IT edhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, përveç punës sipas Rregullores Standart për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, kryen gjithashtu detyrat e Kordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe të personit të kontaktit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Koordinatorja për asistencën e viktimave të krimit asiston rastet e të miturve në konflikt me ligjin, të miturve viktima dhe dëshmitarë, si dhe rastet e dhunës me bazë gjinore duke bërë gjithashtu koordinimin me sistemet referuese. Mban gjithashtu edhe regjistrin e referimeve të veprave penale me të mitur si dhe në zbatim të Urdhërit nr. 11, datë 06.10.2023 “Mbi Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, hedh të dhënat në sistem.

Sa i përket sigurisë, kjo është realizuar nëpërmjet kontratës së lidhur me shoqërinë “**Illyrian Guard**”sh.a Tiranë.

Nuk rezulton të ketë pasur problematika lidhur me sigurinë, megjithatë, ashtu siç jemi shprehur edhe në raporte të viteve paraardhëse në godinën e Prokurorisë Lezhë mungojnë kamerat e sigurisë pasi ata janë të dëmtuara dhe ka vite që nuk funksionojnë. Për këtë fakt është vënë në dijeni edhe Prokurori i Përgjithshëm me shkresë. Gjithashtu mungon sistemi i sigurisë së prokurorisë për të regjistruar hyrjet dhe daljet në godinë.

Përgjatë vitit 2023 vlerësoj se është respektuar disiplina në punë dhe etika nga prokurorët, oficerët dhe punonjësit e administratës.

## **VIII-INFORMACION PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAT**

Gjatë vitit 2023 për shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe mediat, për sa i përket kësaj pjese me urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë është caktuar një prokuror dhe punonjësi i IT-së pranë prokurorisë për shërbimet në marrëdhënien me publikun dhe mediat dhe nuk janë konstatuar problematika.

## **IX-DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2023 DHE REKOMANDIME**

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, paraqesim përfundimet dhe rekomandimet që mendojmë se i do i shërbejnë punës së mëtejshme të Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë:

Përfundimi më i rëndësishëm i analizës së mësipërme është konstatimi i faktit të rritjes së vazhdueshme të ngarkesës efektive të Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë përgjatë vitit 2023. Duke marrë në konsideratë kontekstin aktual ligjor, si edhe ngarkesën e punës së prokurorëve dhe oficerëve, ashtu siç është propozuar edhe në vitet paraardhëse, do të vlerësoja se një numër më i lartë prokurorësh do të bënte të mundur vijueshmërinë normale të punës në Prokurori duke plotësuar organikën totale prej 14 prokurorësh.

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, paraqesim përfundimet dhe rekomandimet që mendojmë se i do i shërbejnë punës së mëtejshme të Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë:

